

VEPRIMTARIA E PROFESOR REXHEP QOSJES GJATË VITEVE 1968-1990 NË DRITËN E DISA DOKUMENTEVE ARKIVORE TË SHTETIT SHQIPTAR

Nuridin AHMETI

Instituti Albanologjik-Prishtinë

Abstrakt

Në muajin maj të vitit 1968, në Prishtinë u organizua Simpoziumi shkencor për nder të 500 vjetorit të vdekjes së Skënderbeut. Në këtë organizim, kishin prezantuar studiues shqiptarë nga Tirana, Prishtina, Shkupi etj., dhe të huaj me kumtesa. Në mesin e studiuesve që prezantuan me kumtesa në këtë organizim shkencor, ishte edhe Profesor Rexhep Qosja. Pas kthimit në Tiranë, studiuesit nga Tirana, që kishin ardhur me kumtesa në Prishtinë, në organet përkatëse të Shqipërisë do të dërgojnë relacion rreth qëndrimit, kontakteve, përshtypjeve të tyre në Prishtinë. Në këtë relacion, duke folur për studiuesit me të cilët ishin takuar, ata shkruan edhe për Profesor Rexhep Qosjen. Nga viti 1968 dhe në vazhdim, pothuajse kemi disa shënime rreth personalitetit të Profesor Rexhep Qosjes të përpiluara kryesisht nga njerëz të institucioneve kulturore të Tiranës. Bie fjala, shënime rreth vizitës së Profesor Rexhep Qosjes në Tiranë për të hulumtuar rreth punimit të tij të doktoratës, shënime rreth mbrojtës së disertacionit të doktoratës të Profesor Rexhep Qosjes, mendime për disa albanologë në Prishtinë, mendimet e Profesor Rexhep Qosje rreth zhvillimit të letërsisë shqiptare në Kosovë etj.

Për sa më sipër, ne kemi tubuar disa nga dokumentet arkivore që flasin për Profesor Rexhep Qosjen gjatë viteve që kemi marrë në shqyrtim, duke hulumtuar edhe literaturë përkatëse do të japim një tablo të përgjithshme rreth këtij personaliteti të kulturës shqiptare. Këto materiale, mbajnë shënime jo vetëm rreth veprimtarisë së Profesor Rexhep Qosjes gjatë këtyre viteve, por edhe për disa zhvillime kulturore e politike në vendin tonë, dhe për shqiptarët në ish-Jugosllavi.

Fjalë kyçe: Rexhep Qosja, Prishtina, Tirana, letërsia, botimet, universitetet, profesorët, literatura, shkrimtarët etj.

Simpoziumi për Skënderbeun më 1968

Në maj të vitin 1968, në Prishtinë organizohet Simpoziumi shkencor për nder të 500 vjetorit të vdekjes së Skënderbeut. Siç është tanimë e njohur, ky organizimi tuboj studiuesi nga ish-Jugosllavia, Tirana dhe albanolog të huaj. Në mesin e studiuesve që do të paraqitet me kumtesa në këtë organizim, ishte edhe Profesor Rexhep Qosja, me kumtesën: “Skënderbeu në vizionin poetik të Naim Frashërit”.¹ Shtypi, aso kohe shkruante për paraqitjen me kumtesë në këtë organizim të Profesor Rexhep Qosjes.² Një pesë e kumtesës së paraqitur në këtë organizim nga profesor Qosja, u botua të nesërmen në shtyp.³ Në lidhje me këtë, studiuesit nga Tirana⁴, pjesëmarrës në këtë organizim, me rastin e kthimit të tyre në Tiranë, kishin përgatitur për institucionet përkatëse të Tiranës një raport, të titulluar: “Mbi vizitën e grupit të punonjësve shkencorë të Universitetit Shtetëror të Tiranës në Kosovë me rastin e Simpoziumit kushtuar

¹ “U rrahen edhe ca çashtje të gjuhës”, *Rilindja*, 12 maj, Prishtinë, 1968, f. 5.

² “Ndonse afiniteti didaktik i natyrës së poetit ndikon në vlerën estetike të “Historisë së Skënderbeut” (nga N. Frashëri) megjithatë kjo vepër do të jetë aktuale dërsia në botën tjetër të kësaj lloji që rrezikojnë lirinë dhe integritetin e tjetrit dhe njerëz që duhet luftojnë për ta ruajtur krenarinë e tyre”- e prezantonte një fragment nga kumtesa e Profesor Qosjes, revista: *Zani i rinisë*, nr. 21, 18 maj, Prishtinë, 1968, f. 5.

³ Rexhep Qosja, “Skënderbeu në vizionin e Naim Frashërit”, *Rilindja*, 13 maj, Prishtinë, 1968, f. 8.

⁴ Në fund të këtij raporti figurojnë emrat e profsorëve: Aleks Buda, Ndreçi Plasari, Bujar Hoxha, Dhorka Dhamo, Mediha Shuteriqi dhe Thoma Murzaku. Ana Lalaj, “1968-1969-shkrirja e akujve në bashkëpunimin kulturor Shqipëri-Kosovë”, *Studime historike*, nr. 3-4, QSA-IH, Tiranë, 2015, f. 273.

Skënderbeut”.⁵ Ata kishin shënuar se gjatë qëndrimit të tyre në Kosovë, atyre ju bë “në përgjithësi një pritje zyrtare korrekte”⁶ nga ata të cilët ishin ftuar, pra “nga drejtuesit e Instituti Albanologjik dhe nga bashkësia e shkollave të larta në Prishtinë”.⁷

Në pjesën e këtij raporti, ku shkruan për kumtesat dhe referatat të mbajtura në këtë organizim nga studiuesit shqiptarë në ish-Jugosllavi, ata theksojnë: “Përgjithësisht mund të thuhet se kumtesat e mbajtura nga shqiptarët vendas ishin në një nivel shkencor mjaft të ulët; ato i përshkonte përgjithësisht fryma patriotike por metodologjikisht ishin të dobëta dhe nuk sillnin ndonjë rezultat shkencor për t’u shënuar”.⁸ Për Profesor Ali Hadri, ata kishin bindjen, si ai ishte “njeriu i mbështetur nga regjimi titist”⁹, ndërsa për referatin e mbajtur nga ai, ata e vlerësojnë si një referat “në një nivel shkencor të ulët, më tepër një ritregim faktesh, pa ndonjë material dhe koncept të ri të vetin”.¹⁰

Mirëpo, sipas përgatitësve të raportit “nga kumtesat me të mira”¹¹ mund të konsiderohet ajo e Rexhep Qosjes me titull: “Skënderbeu në vizionin poetik të Naim Frashërit” që binte në sy për trajtimin e thellë e të drejtë të temës, për kulturën e gjerë të autorit”.¹² Profesor Qosja, nga ky moment, do të jetë ndër me të përmendurit në relacione e informacione të përgatitura në Tiranë, kryesisht, për punën e vyer të tij në drejtim të letërsisë shqipe dhe kritikës letrare. Janë disa studiues nga Kosova, që vlerësohen nga studiuesit e Tiranës, për paraqitjet e tyre në këtë organizim, por Profesor Qosja dhe paraqitja e tij, kishte lenë mbresa të theksuara te ata.

Profesor Rexhep Qosja 1970-1990

Viti 1970, është i begatshëm sa i përket dokumentacionit që lidhet me personalitetin e Profesor Rexhep Qosjes, sepse gjatë këtij vitit Profesori do ta vizitoj Shqipërinë dhe sigurisht se ka prodhuar material edhe për përgatitësit e relacioneve. Prej datës 6 deri më 28 janar 1970 Profesor Qosja qëndron në Tiranë si i ftuar nga Universiteti Shtetëror i Tiranës. Gjatë kësaj kohe, Profesor Qosja kishte hulumtuar dhe mbledhur materiale për punimin e tij të disertacionit “Asdreni: jeta dhe krijimtaria letrare”. Me 6 shkurt të vitit 1970, sipas kërkesës së Behar Shtyllës, studiuesi Androkli Kostallari i dërgon relacion në lidhje me qëndrimin e Profesor Qosjes në Tiranë dhe një informacion në lidhje me gjendjen e letërsisë shqipe në Kosovës sipas, mendimeve të Profesor Qosjes. Sipas, këtij relacioni, Profesor Rexhep Qosja “është një kritik me talent dhe një punonjës i zellshëm në fushën e studimeve historiko-letrare. Ai ka një horizont të gjerë letrar dhe premtion për punë ngulmonjëse e serjoze në lëmin e studimeve të letërsisë shqiptare”¹³- shkruan në mes tjerash në këtë relacion.

Sipas, relacionit të përgatitur, Profesor Qosja, vlerëson përparimet e mëdha të Shqipërisë “në lëmin ekonomik e kulturor, atij i ka bërë përshtypje të veçantë fakti që në Shqipëri ka ndryshuar dhe fizionomia e njeriut, është formuar një njeri i ri, me tipare të reja”¹⁴- shkruhet në mes tjerash në këtë relacion. Ndërsa sa i përket aspektit fetar në Shqipëri, sipas relacionit Profesor Qosja,

⁵ *Po aty*, f. 253.

⁶ *Po aty*.

⁷ *Po aty*.

⁸ *Po aty*, f. 256.

⁹ *Po aty*.

¹⁰ *Po aty*.

¹¹ Vlerësime pozitive, përgatitësit e raportit kishin edhe për dy studiues nga Prishtina Skender Rizajn dhe Hasan Kaleshin. “Për ndonjë material të ri nga arkivat turke kishin interes kumtesat e Skender Rizajt dhe Hasan Kaleshit, ndonëse nuk mungonin nga ana tjetër, edhe pikëpamjet të shtrembra në lidhje me vlerësimet e pushtimit osman (në këtë çështje ata janë viktime të mënyrës shtrembëruese të të parit të këtij problemi që gjendet të një varg historianesh turq, gjermano-perëndimor)”. Ana Lalaj, “1968-1969-shkrirja e akujve...”, f. 265.

¹² *Po aty*.

¹³ Arkivi Qëndror i Shtetit-Tiranë (më tej: *AQSH*), F. 14APSTR, V. 1970, D. 345.7, fl. 9. Informacion lidhur me studiuesit nga Kosova të dalluar në fushën e studimeve albanologjike. Tiranë, më 1970.

¹⁴ *AQSH*, F. 14APSTR, V. 1970, D. 321, fl. 4. Relacion për punën e kryer gjatë qëndrimit në vendin tonë nga Bashkëpunëtori shkencor i Institutit Albanologjik të Prishtinës Rexhep Qosja. Tiranë, më 6 shkurt 1970.

faktin e ateizimit të Shtetit shqiptarë e sheh si domethenës “ që Shqipëria është vendi i parë në botë pa kisha e pa xhami”¹⁵-shkruan në mes tjerësh në relacion

Ndërsa, sa i përket relacionit në lidhje me gjendjen e letërsisë shqipe në Kosovë, në relacion shënohen mendimet e Profesor Rexhep Qosjes për letërsinë në përgjithësi, romanin, prozën, poezinë, letërsinë për fëmijë etj., duke veçuar edhe emra të veçantë si: Hivzi Sylejmani, Esad Mekuli, Enver Gjergjeku etj. Bie fjala, për Esad Mekulin, në relacion shënohet ky mendim i Profesor Qosjes se “pikënisje e frymëzimit të tij është po ai fshatar, po ai njeri që herë i thonë shqiptar, herë shifitar, herë lypës e herë sharraxhi. Si poet E. Mekuli ndjen thellë në shpirt imperativin e lirisë dhe krijon kultin e saj. Plagë e veçantë, e pashëruar ende, është plaga e kurbetit. Këtë temë e ka trajtuar me forcë të rrallë”¹⁶- shkruan në mes tjerash në këtë relacion. Në vitin 1970, në Tiranë përgatitet një informacion lidhur me studiuesit e dalluar të Kosovës në fushën e albanologjisë. Në këtë informacion, ofrohet nga një rezyme e shkurtër për studiuesit: Idriz Ajeti, Ali Hadri, Mark Krasniqi, Syrja Pupovci, Femi Agani, Hajredin Hoxha, Hasan Kaleshi, Rexhep Qosja, Zekeria Cana, Skender Rizaj, Ahmet Kelmendi, Ismet Dërmaku, Latif Mulaku, Anton Çeta, Isak Shema, Halit Tërnafc, Ramiz Kelmendi, Shefqet Pllana e Olivera Jashari-Nasteva. Për Profesor Rexhep Qosjen, ata shkruajnë me nota pozitive, duke e shënuar këtë vlerësim: “Kritik letrar, historian i letërsisë shqipe; shef i sektorit të historisë së letërsisë në Institutin Albanologjik, pedagog në fakultetin përkatës. Ka një pregatitje serioze shkencore me mendime pozitive, është prodhues aktiv, autor i një vargu librash e studimesh, në të cilat përpiket për një kuptim ideologjik të drejtë të fenomeneve të historisë së letërsisë shqipe dhe ngul këmbë për të ndjekur vijën drejtuese të shkencës sonë albanologjike. Ishte në vendin tonë për studime kohë më parë dhe mban qëndrim shumë të mirë ndaj nesh”¹⁷- shkruan në këtë informacion.

Në fund të vitit 1970, në Prishtinë, Shoqata e Shkrimtarëve të Kosovës, kishte organizuar një akademi përkujtimore me rastin e 70 vjetorit të vdekjes së Naim Frashërit. Delegacioni nga Tirana ishte i përberë nga Dhimitër S. Shuteriqi, në cilësinë e kryetarit, Zija Xholi dhe kompozitori Tizh Daija. Ky delegacion, në Prishtinë kishte ardhur përmes Strugës dhe në kufij ishte pritur nga Mark Krasniqi, në cilësinë e Kryetar të shoqatës, profesor në Universitetin e Prishtinës dhe shkrimtar; Vehap Shita, Sekretar i Shoqatës, redaktor i gazetës "Rilindja", kritik letrar, Azem Shkreli, anëtar i kryesisë së shoqatës, Drejtor i Teatrit të Prishtinës, shkrimtar, Maksut Shehu, anëtar i kryesisë së shoqatës dhe shkrimtar. Në relacionin e dërguar në institucionet përkatëse në Tiranë, ata shënojnë se organizimi i kësaj akademie përkujtimore u mbajti në Teatrin krahinor të Prishtinës, siç quhej aso kohe dhe fjalën e rastit e mbajti kritiku letrar Rexhep Qosja, por për fjalën e tij ata shtojnë se “fjalimi i Qoses nuk qe dhe aq në nivel, në krahasim me aftësitë e tij, po jo keq”.¹⁸ Në të njëjtin relacion, në disa faqe me poshtë, kur flasin për Profesor Qosjen, ata shkruajnë: “Ky është ndër njerzit më me kulturë që kanë, talent i veçantë për kritikën dhe historinë letrare, punëtor i madh, ende fort i ri (më pak se 35 vjeç). Të gjithë e paraqesin si njeri shumë të ndershëm dhe i tillë na u duk. Ka admirim të madh për punën që bëhet tek ne, po në shkrimet e tij nuk mungon, në mënyrën e vet, një farë polemizimi me kritikën dhe historiografinë tonë letrare”.¹⁹

Më 20 mars, të vitit 1971 Rexhep Qosja, në amfiteatrin e madh të Fakultetit Filozofik të Prishtinës, mbron temën e disertacionit “Asdreni: jeta dhe krijimtaria letrare”²⁰, para komisionit të përberë nga Profesorët: Idriz Ajeti, Aleks Buda, Androkli Kostallari, Jashar Rexhepagiqi dhe

¹⁵ *Po aty*, fl. 5.

¹⁶ AQSH, F. 14APSTR, V. 1970, D. 321, fl. 10-11. Relacion mbi disa të dhëna për gjendjen dhe prirjet e zhvillimit të letërsisë shqiptare në Kosovë (sipas dëshmive të Rexhep Qoses). Tiranë, më 6 shkurt 1970.

¹⁷ AQSH, F. 14APSTR, V. 1970, D. 321, fl. 1-2.

¹⁸ AQSH, F. 14APSTR, V. 1970, D. 345.6, fl. 4. Relacion mbi vajtjen në Kosovë të një delegacioni të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë. Tiranë, më 24 dhjetor 1970.

¹⁹ AQSH, F. 14APSTR, V. 1970, D. 345.6, fl. 12.

²⁰ “Lajmërim”, *Rilindja*, 19 mars, Prishtinë, 1971, f. 15.

Ali Hadri. Të nesërmen, me 21 mars shtypi, përmes gazetarit të atëhershëm, shkrimtarit të njohur Musa Ramadanit shkruante: “Rexhep Qosja-doktor i shkencave filologjike”²¹ dhe “kjo ishte e para mbrojtje e disertacionit në gjuhën shqipe në Jugosllavi”.²² Në lidhje me këtë, dy studiuesit e njohur nga Tirana, Profesorët Buda dhe Kostallari, në informacionin e tyre, të përgatitur për këtë ngjarje, shënuan, se ishte ngjarje me rëndësi të jashtëzakonshme, manifestim i fuqishëm si në aspektin patriotik dhe atë politik, një atmosferë ndoshta e pa parë deri në atë kohë dhe i vlerësonin jashtëzakonisht, falënderimet për institucionet e Tiranës që Profesorët Qosja dhe Ajeti, i kishin potencuar vazhdimisht gjatë ceremonisë së mbrojtjes së disertacionit.²³ Për deri sa në vitin 1971, kemi vlerësime pozitive për figurën e Profesor Rexhep Qosjes nga Tirana, gjatë hulumtimeve, kemi hasur edhe dokumentacione, me mendimet të studiuesve nga Kosova për kolegët e tyre, që në shumicën e rasteve janë përshkrime emocionale. Bie fjala, në një informacion sekret të vitit 1971, shënojnë disa mendimet të Ali Aliut, Vehap Shitës, Ali Podrimes e Esat Mekulit, të shprehura gjatë qëndrimit të tyre në Shqipëri për letërsinë në Kosovë, e rrjedhimisht edhe për disa shkrimtar e studiues të kësaj fushe. Profesor Ali Aliu, është studiuesi që flet me tone pezhorative në lidhje me figurën e Rexhep Qosjes. “Njerzit nga Kosova dhe sidomos intelijenca”²⁴-thoshte Ali Aliu, “kanë nevojë të vijnë në Shqipëri për të pastruar mushkëritë, se i kanë shumë të fëlliqura. Ja Rexhep Qosja nuk është pastruar mirë ndërsa Ali Podrimja ka nevojë të jetojë gjatë këtu dhe t’i pastrohen mirë!”²⁵-shkruan në mes tjerash në këtë informacion sekret. Përgatitësi i informacionit shënon edhe më tepër, fjalë nga studiuesi Ali Aliu, i cili thoshte se Ali Podrimja “nuk është i pastër dhe nuk i duhen marrë në konsideratë fjalët e tij. Punon bashkë me Rexhep Qosen për të shkatërruar edhe atë çka është e mirë në letërsinë e Kosovës”²⁶-shkruan përveç tjerash në këtë informacion.

Gjatë vitit 1973, emrin e Profesor Qosjes e hasim në relacione ku flitet për qëndrimin e Ali Hadrit në Shqipëri dhe, se si ky, gjatë qëndrimit në Tiranë ishte i interesuar të njihej me një artikull të Ismail Kadaresë, të botuar te “Zëri i popullit”, ku indirekt kritikohej Rexhep Qosja, dhe se si Ali Hadri ishte kundër kritikës së ashpër të Rexhep Qosjes ndaj Ismail Kadaresë.²⁷ Gjithashtu, emri i Profesor Qosjes gjatë vitit 1973 na shfaqet edhe në relacione, rreth organizimeve të përbashkëta hulumtuese në teren, të studiuesve nga Tirana dhe Prishtina, të cilët kishin ardhur për ekspedita nga fusha e gjuhësisë dhe folklorit në Kosovë, ku profesor Qosja i takon studiuesit nga Tirana në cilësinë e drejtorit të Instituti Albanologjik.²⁸

Në vitin 1974, personalitetin e Rexhep Qosjes e hasim në relacionin e përgatitur nga studiuesi Bahri Beci. Profesor Qosja, në këtë vit kishte qëndruar në Tiranë se bashku me bashkëshorten e tij Shpresën, për hulumtime, dhe si i ftuar nga Universiteti i Tiranës për ta mbajtur një ligjëratë me titull: “Për disa çështje të periodizimit të letërsisë shqipe” me punonjës shkencorë dhe profesorë të letërsisë të Universitetit Shtetëror të Tiranës. Profesor Qosja, vlerëson punën e shkrimtarëve në Shqipëri dhe shprehet se për ta “ka mjaft konsideratë, janë sipas tij punëtorë dhe shkruajnë mirë. Ai vinte në dukje si veçori pozitive të shkrimtarëve J. Xoxa e I. Kadare punën e tyre këmbëngulëse për të ngritur nivelin e tyre të përgjithshëm”.²⁹

Profesori dhe bashkëshortja e tij, janë të kënaqur për mikpritjen që ju behët në Tiranë dhe nuk hezitojnë ta shprehin, se “pritja që ju bëhej këtu ishte shumë e mirë dhe shfaqën keqardhjen që

²¹ *Rilindja*, 21 mars, Prishtinë, 1971, f. 2.

²² *Po aty*.

²³ *AQSH*, F. 14APSTR, V. 1971, D. 423, fl. 21. Informacion mbi mbrojtjen e disertacionit të doktoratës të Rexhep Qosës në Prishtinë. Tiranë, më 2 prill 1971.

²⁴ *AQSH*, F. 14APSTR, V. 1971, D. 425, fl. 97-101. Informacion sekret i përgatitur nga Kryetari i degës së veçantë Haki Keta. Tiranë, më 7 qershor 1971.

²⁵ *Po aty*.

²⁶ *AQSH*, F. 14APSTR, V. 1971, D. 425, fl. 97-101-102.

²⁷ *AQSH*, F. 14APSTR, V. 1973, D. 274, fl. 11. Relacion mbi qëndrimin në Shqipëri të profesor doktor Ali Hadrit. Tiranë, më 5 qershor 1973.

²⁸ *AQSH*, F. 508, V. 1973, D. 67, fl. 12. Relacion mbi ekspeditën gjuhësore dhe folklorike në Kosovë në periudhën 6. 7 deri 5. 8. 1973. Tiranë, më 30 gusht 1973.

²⁹ *AQSH*, F. 508, V. 1974, D. 89, fl. 41. Relacion mbi qëndrimin në vendin tonë të studiuesit Rexhep Qosja dhe të shoqës Shpresa Qosja. Tiranë, më 12 qershor 1974.

nuk mund të na bënin të njëjtën pritje edhe në Prishtinë. Ndër të tjera sipas tyre ushqimi në hotel Dajti ishte më i mirë se ai i Bozhurtit, pritja shumë e mirë dhe e organizuar”³⁰ - shkruhej përveç tjerash në relacion.

Ndërsa, sa i përket ligjëratës së mbajtur, përgatitësi i relacionit shprehet se “leksioni i tij, siç del edhe në relacionin e veçantë të përgatitur për të, ngjalli mjaft diskutime për shkak të ideve të tij themelore, të cilat sipas nesh nuk përputheshin me kriteret e analizës klasore dhe shquheshin nga një përpjekje për mënjanimin e kufijve të qartë midis letërsisë së realizmit socialist nga njera anë dhe letërsisë së paraçlirimit nga ana tjetër, të letërsisë sonë nga njera anë dhe asaj kosovare nga ana tjetër. Pjesërisht disa nga këto pikëpamje ai i ka shfaqur edhe më parë në artikujt që ka botuar si edhe në bisedat që kemi patur rastin të bëjmë me të. Në përgjithësi ai mendon se kriteri formalist dhe ai sociologjik janë të dëmshme për letërsinë. Për atë me analizën klasore nuk mund të shpjegohen fenomenet e ndërlikuara letrare, të cilat kanë specifikën e vet dhe mund të shpjegohen vetëm duke u nisur prej tyre”³¹ - thuhet në mes tjerash në këtë relacion. Duhet potencuar, se në lidhje me këtë ligjëratë dhe qëndrimet e Profesor Qosjes, rreth periodizimit të letërsisë shqipe, studiuesit e Tiranës e trajtojnë shumë seriozisht, dhe siç duket, janë venë në siklet, sepse për të njëjtin aspekt, pra, periodizimin e letërsisë shqipe të trajtuar nga Profesor Qosja, në instanca të caktuara dërgohen tri materiale në formë relacioni dhe informacioni. Materialet dërgohen nga Bahri Beci³², Nuri Çausi³³ dhe Bujar Hoxha.³⁴ Dokumentet e dy të parëve, mbajnë të njëjtën datë të përpilimit, ndërsa ai i Bujar Hoxhës është dy ditë më pas. Kjo tregon edhe për nivelin e shqetësimit që ka shkaktuar ligjëratat dhe qëndrimet e Profesor Qosjes në këtë aspekt, sepse nga hulumtimet e gjertanishme, kemi hasur materiale edhe për studiuesit e tjerë nga Prishtina që kanë mbajtur ligjëratat në Tiranë dhe pas disa ditësh është dërguar relacioni etj. Por që brenda dy ditëve të dërgohen tri relacione e informacione për të njëjtin person dhe të njëjtën ligjëratë, ne këtë e kemi hasur vetëm më rastin e Profesor Qosjes. Në lidhje me qëndrimet e shprehura të Profesor Qosjes, rreth periodizimit të letërsisë shqiptare, studiuesit e Tiranës, do të marrin mendimin edhe të disa studiuesve tjerë nga Kosova që do të qëndrojnë për vizita në Tiranë. Në lidhje me këtë, sipas një relacioni, Profesor Ali Hadri do të deklaronte “se Rexhepi nuk kishte të drejtë. “Shumë mirë ia bënë, Rexhepi ka nevojë t’i ulët pak hunda”. Vlerësoi diskutimin e sh. Aleks Buda, Jorgo Bulos dhe Koço Bihikut”³⁵ - shkruante në mes tjerash në këtë relacion. Ndërsa, në lidhje me këtë çështje ishte deklaruar edhe Profesor Isak Shema, mendimin të cilin e kishte shënuar në relacion studiuesi Thanas Gjika. “Në një bisedë që i hapa lidhur me mendimin e tij për periodizimin e letërsisë shqiptare” shkruan në relacion, “ai mbështeti plotësisht periodizimin që është bërë në tekstet tona dhe rrëzoi periodizimin që ka bërë Dr. Rexhep Qosja si një periodizim i nisur nga pozita formaliste. I. Shema është një njohës i mirë i letërsisë sonë të realizmit socialist dhe kjo ka bërë që ai të dallojë mirë kthesën që bëri letërsia jonë në vitet e para të pasçlirimit duke e parë këtë letërsi si një letërsi të një etape esencialisht të re”.³⁶

Kur jemi të mendimet e shprehura nga studiuesit Hadri e Shema, në lidhje me Rexhep Qosjen, duhet potencuar, se dy studiuesit kanë kontribute shkrimore me vlera në fushat e tyre të interesimit shkencor. Por Ali Hadri, ishte studiues i historisë dhe jo letërsisë, andaj mendimet tij në këtë drejtim, nuk duhet të merren si të mirëqena edhe studiuesi Isak Shema, si studiues i letërsisë për kohen kur kishte deklaruar, nuk shquhet për ndonjë punim monografik nga fusha

³⁰ Po aty.

³¹ AQSH, F. 508, V. 1974, D. 89, fl. 40-41.

³² Po aty.

³³ AQSH, F. 508, V. 1974, D. 89, fl. 42-45. Informacion mbi ligjëratën “Për disa çështje të periodizimit të letërsisë shqipe” të Prof. Rexhep Qosës mbajtur me punonjës shkencorë dhe pedagogë të letërsisë të USHT. Tiranë, më 12 qershor 1974.

³⁴ AQSH, F. 14APSTR, V. 1974, D. 416, fl. 1-3. Relacion mbi disa probleme që ngrii grupi kosovar që vizitoi vendin tonë. Tiranë, më 14 qershor 1974.

³⁵ AQSH, F. 508, V. 1974, Dosja 89, fl. 51. Relacion mbi qëndrimin në vendin tonë të studiuesve kosovarë Profesor doktor Ali Hadri, Profesor doktor Skender Riza dhe pedagog Emin Pllanës. Tiranë, më 8 korrik 1974.

³⁶ AQSH, F. 508, V. 1974, D. 89, fl. 57. Relacion për shoqërimin e studiuesit kosovar Isak Shema. Tiranë, më 11 shtator 1974

e letërsisë shqiptare. Pjesa dërmuese e veprimtarisë shkrimore të tij, përfshinë, fillimet e viteve të '90-ta dhe më pas.³⁷ Andaj, deklaratimet e profesorëve Hadri e Shema, në lidhje me ligjëratën e Rexhep Qosjes, me tepër janë për mos t'ua "prishur qefin" kolegëve të Tiranës, se sa mendime profesionale dhe të bazuara.

Sado që ligjëratat e Profesor Qosjes kishte bërë bujë në Tiranë, ndoshta edhe nuk i kishte përmbushur pritjet e studiuesve të Tiranës, Profesor Qosja, nuk e shënon një ngjarje si kjo në Ditarin e botuar të tij.³⁸ Sipas dokumentacionit, ligjëratat ishin mbajtur në muajin qershor të vitit 1974, e po ashtu edhe relacionet ishin dërguar gjatë këtij muaji, mirëpo në ditarin e Profesor Qosjes, në këtë vit, për këtë muaj, nuk shënon asnjë ndodhi. Në këtë ditar, kemi shënime deri në muajin maj dhe më pastaj vazhdon me muajin korrik³⁹ të vitit 1974. Siç duket, Profesori, për këtë ngjarje, si edhe për disa ngjarje të tjera, të ndodhura në jetën tonë kulturore e politike gjatë viteve, e ka dhënë mendimin e tij përmes deklaratave, në kohën e duhur e në vendin e duhur dhe, nuk ka dashur të jep vlerësime të mëtutjeshme në Ditar të botuar. Ndoshta, për disa ngjarje, ku përfshihet emri i tij, ua ka lenë ta thonë të tjerët.

Nga viti 1976 e deri më 1980, në dokumentacionet e hulumtuara, emrin e Profesor Qosjes e hasim në cilësinë e pritësit të delegacioneve me studiues, shkrimtar e artist nga Tirana.⁴⁰ Në vitin 1980, në Tiranë, kishin qëndruar për vizitë zyrtare Profesorët të shoqëruar edhe nga bashkëshortet e tyre, Idriz Ajeti, në cilësinë e Kryetarit të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Rexhep Qosja në cilësinë e Drejtorit të Institutit Albanologjik dhe Ali Hadri në cilësinë e Drejtorit të Institutit të Historisë. Delegacioni nga Kosova, ishte pritur shumë mirë nga drejtuesit e Institucioneve shkencore në Tiranë. Gjatë qëndrimit në Shqipëri, Rexhep Qosja, në ambientet e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë kishte mbajtur ligjëratën: "Karakterit historik i rimës" dhe e cila ishte pritur mirë nga të pranishmit. Profesor Qosja, kishte ngritur si shqetësim" një problem të mprehtë të jetës së tyre atje, atë të fushatës denigruese që sipas tij, disa forca, po zhvillojnë prej kohe kundër tij dhe figurave të tjera të kulturës e të shkencës në Kosovë".⁴¹

Në bisedë e sipër Rexhep Qosja sipas përgatitësve të relacionit përsërit "kërkesën e vazhdueshme të intelektualëve kosovarë, se ka ardhur koha që ne në Shqipëri të studiojmë letërsinë e shqiptarëve në Jugosllavi, ta përfshijmë atë në studimet e tekstet tona dhe ta vlerësojmë me "të mirat dhe të këqiat" që ka. Ai e quan krejt të pamjaftueshëm faktin që botojmë veprën e ndonjë autori kosovar. Nga ana tjetër ai nuk e quan të saktë përdorimin e termit "letërsi e Kosovës" sepse nuk duhet të jetë kriteri regional e administrativ, po ai kombëtar që i jep emrin një letërsie".⁴²

Në vitin 1980, profesor Kristaq Prifti i dërgon Ramiz Alis një material studimor me këtë porosi: "Shoku Ramiz, po ju çoj studimin "Mendime rreth letërsisë dhe kritikës shqiptare në Kosovë, në Maqedoni e Mal të Zi" si edhe një informacion më të plotë rreth librit të fundit të R. Qoses "Morfologjia e një fushate", të hartuar sipas porosisë tonë"⁴³- shkruan në këtë shkresë.

Materiali "Mendime rreth letërsisë dhe kritikës shqiptare në Kosovë, në Maqedoni e Mal të Zi", ishte përgatitur nga studiuesit Nasho Jorgaqi, Dalan Shaplllo e Jorgo Bullo. Rexhep Qosja, në këtë material përmendet, kur flitet për romancierët shqiptarë në Jugosllavi dhe kur flitet për kritikën letrare. Në dy rastet, figura e profesor Qosjes vlerësohet lartë.⁴⁴ Ndërsa, materiali rreth librit "Morfologjia e një fushate" është përgatitur nga studiuesit Nasho Jorgaqi e Jorgo Bullo.

³⁷ Fjalori Enciklopedik i Kosovës II, ASHAK, Prishtinë, 2018, f. 1579-1580.

³⁸ Rexhep Qosja, *Ditari I*, Toena, Tiranë, 2014, f. 449-564.

³⁹ Po aty, fl. 475.

⁴⁰ AQSH, F. 14APSTR, V. 1976, D. 585, fl. 14. Relacion mbi punën dhe qëndrimin në Kosovë gjatë periudhës 16 qershor 1976-16 korrik 1976. Tiranë, më 30 korrik 1976.

⁴¹ AQSH, F. 508, V. 1980, D. 87, fl. 6. Relacion mbi qëndrimin në vendin tonë të Kryetarit të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës Prof. Idriz Ajeti, Drejtorit të Institutit Albanologjik të Prishtinës, Prof. Rexhep Qosja dhe Drejtorit të Institutit të Historisë së Kosovës, Prof. Ali Hadri me bashkëshortet (26, I-4. II.1980). Tiranë, më 13 shkurt 1980.

⁴² AQSH, F. 508, V. 1980, D. 87, fl. 6.

⁴³ AQSH, F. 14APSTR, V. 1980, D. 86, fl. 1. Letër e Kristaq Priftit dërguar Ramiz Alisë. Tiranë, më 10 maj 1980.

⁴⁴ AQSH, F. 14APSTR, V. 1980, D. 86, fl. 6, 10.

Siç edhe dihet, ky është një libër, botimit i të cilit ka shkaktuar mjaftë polemika në Kosovë. Nga të parët që ka reaguar rreth botimit të këtij libri, ishte Profesor Fehmi Agani, përmes një shkrim me dy vazhdime në shtyp.⁴⁵ Profesor Agani këtë botim e quan Pamflet i cili “u botua dhe u shit shpejt dhe u lexua “me ëndje”, si e parashihte autori”⁴⁶- shkruan përveç tjerash në këtë publikim. Ndërsa, e përfundon, shkrimin e tij, Profesor Agani, me këto fjalë: “Objekt i këtij vështrimi nuk ishte ajo që mund të jetë punë e rezultat me vlerë i RQ. Objekt i shqyrtimit është dështimi dhe pamfletizmi i tij”⁴⁷-shkruan Fehmi Agani. Në lidhje me këtë reagim, Profesor Qosja, në Ditarin e botuar të tij shprehet i habitur, sepse ai nuk e kishte pritur se ky njeri të reagoj, të tregohet i pa përmbajtur. Sipas tij, nuk kishte arsye Fehmi Agani të reagonte, kur dihet se “ai nuk ishte protagonist, madje as personazh me rëndësi si më të dukshme në këtë libër”⁴⁸-shkruan Rexhep Qosja.

Botimi i këtij libri nga përgatitësit vlerësohet me tonë rënduese ndaj Profesor Qosjes. Për më tepër, ata shënojnë se “botimi i një vepre të kësaj natyre, me fyerje dhe me banalitete, pa asnjë vlerë shoqërore, pa probleme e çështje parimore, nuk është një gjë e jashtëzakonshme në Jugosllavi. Vepra dhe skandale të tilla janë një praktikë e rendomtë e jetës kulturore e artistike atje, qoftë me polemika në shtyp apo me botime librash të veçantë. Kjo quhet prej tyre një lloj letërsie, aq sa R. Qosja pretendon se sjell një kontribut duke themeluar një zhanër të ri në letërsinë shqiptare. Intelktualë të ndryshëm kosovarë që kanë ardhur në vendin tonë ose me shokët tanë që shkojnë atje, herë pas here, tërthorazi, janë përpjekur të bëjnë sondazhe e të marrin mendimin tonë për këto mosmarrëveshje. Me botimin e librit të R. Qoses, grindja do të thellohet, prandaj mendoj se shokët që do të kenë në të ardhmen kontaktet me ta, duhet të udhëzohen lidhur me qëndrimin tonë”⁴⁹- shkruajnë profesorët Jorgaqi e Bulo. Për disa pakënaqësi të shprehura në Tiranë, rreth këtij libri, Profesor Qosjes, disa prej tyre, gojarisht ia sjell nga Tirana studiuesi Sefedin Fetiu. Në lidhje me këto pakënaqësi të shprehura nga disa në Tiranë, Profesor Qosja shkruan: “Është i madh numri i shpifjeve më absurde që pjesëtarët e klani tonë kulturor kanë çuar në Tiranë”.⁵⁰

Ndërsa, sa i përket qëndrimeve të Profesor Jorgo Bulos, të shkruara në relacion, për të cilin kemi bërë fjalë më lartë, edhe Profesor Qosja, pakënaqësitë e kolegut dhe mikut të tij, i shkruan në Ditarin e botuar. Këto pakënaqësi, Profesor Bulo, ia shpreh Profesor Qosjes gjatë një qëndrimi në Prishtinë. “Vërejtjet e tij në lidhje me *Morfologjinë e një fushate* kishin të bënin: e para, me disa shprehje, me disa shprehje që puritanistët do t’i quanin shprehje të ndyta, sikundër është fjala *bythec* për njërin prej personazheve të librit dhe, e dyta, në lidhje me momentin kur është botuar”⁵¹- shkruan në mes tjerash Profesor Qosja.

Gjatë vitit 1980, emrin e Profesor Qosjes në dokumentacione e hasim në rolin e drejtuesit e studiuesit të Institutit Albanologjik⁵² dhe menaxhimit të brendshëm në këtij institucion. ⁵³

Me datën 15 dhe 17 dhjetor të vitit 1980, në Prishtinë ishte organizuar Simpoziumi shkencor: “Probleme aktuale të kulturë së gjuhës shqipe”. Sipas shtypit, në këtë organizim, kishin marr pjesë mbi 70 punonjës shkencor nga studiuesit shqiptarë nga Jugosllavi dhe nga Tirana.⁵⁴ Studiuesit në mes tjerash kishin konstatuar se duhet thelluar me tej hulumtimet e arritura deri

⁴⁵ Fehmi Agani, “Testimonium paupertatis i R. Qosejes”, *Rilindja*, 24 maj, Prishtinë, 1980, f. 12-13; “Iluzionet dhe iluzionet”, *Rilindja*, 7 qershor, Prishtinë, 1980, f. 13-14.

⁴⁶ *Rilindja*, 24 maj, Prishtinë, 1980, f. 12.

⁴⁷ *Rilindja*, 7 qershor, Prishtinë, 1980, f. 14.

⁴⁸ Rexhep Qosja, *Ditari III*, Toena, Tiranë, 2014, f. 206.

⁴⁹ *AQSH*, F. 14APSTR, V. 1980, D. 86, fl.16

⁵⁰ Rexhep Qosja, *Ditari III...*, f. 162.

⁵¹ *Po aty*, fl. 177.

⁵² *AQSH*, F. 14APSTR, V. 1980, D. 87, fl. 2, 4. Relacion institucionet shkencore të Kosovës, struktura dhe problematika e punës së tyre studimore. Tiranë, më 30 qershor 1980.

⁵³ *AQSH*, F. 508, V. 1980, D. 87, fl. 89. Relacion mbi probleme të veçanta të ekspeditës kosovare të kryesuar nga Sekretari i përgjithshëm i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës Prof. Syrja Pupovci. Tiranë, tetor 1980.

⁵⁴ “Fillon Simpoziumi mbi problemet aktuale të gjuhës shqipe”, *Rilindja*, 15 dhjetor, Prishtinë, 1980, f. 14.

me tani⁵⁵ dhe duhet mobilizim më i shtuar për zbatimin e normës letrare.⁵⁶ Në këtë organizmi, kishin marr pjesë edhe këta studiues nga Tirana, Androkli Kostallari, Anastas Dodi, Mahir Domi, Jani Thomaj, Bahri Beci, Emil Lafe, Ferdinand Leka dhe Ali Dhrimo. Sipas praktikës së atëhershme, këta studiues pas arritjes në Tiranë, në instancat përkatëse kishin dërguar edhe informacion rreth qëndrimit të tyre në Prishtinë. Profesor Rexhep Qosja, përmendet se si ai në emisionin televiziv kishte deklaruar për ndihmën që po ua jepnin institucionet shkencore të Tiranës atyre në Kosovë etj. “Në mbarim të Simpoziumit u dha një emision për problemet e kulturës së gjuhës, ku një vend të posaçëm zunë edhe punimet e Simpoziumit. Një ditë më pas u dha një emision i posaçëm për veprimtarinë e Institutit Albanologjik, në të cilin Rexhep Qosja theksoi edhe ndihmën që kanë dhënë institucionet shkencore të RPS të Shqipërisë për forcimin e rritjen e këtij instituti. Në këtë emision Rexhep Qosja përmendi si një ndër botimet e Institutit edhe veprën e tij "Morfologjia e një fushate" gjë që disa punonjës të Institutit nuk e miratuan, sepse mund të shkaktojë reagime të reja”⁵⁷-theksohet në mes tjerash në këtë informacion.

Në muajin mars, të vitit 1981 në Prishtinë shpërthejnë demonstrata e njohura të studentëve të Universitetit të Prishtinës. Tirana, përveç tjerash ishte e interesuar, të ketë informacione më të bollshme rreth gjendjes së albanologjisë në Kosovë pas demonstratave të vitit 1981. Në lidhje me këtë ata përgatitin një studim, në vitit 1982, i cili në fund, mban emrin e nënshkrimit të studiuesit Kristaq Prifti. Ky studim titullohet: “Gjendja e studimeve albanologjike në Kosovë pas ngjarjeve të mars-prillit 1981”. Në këtë studim zë vend edhe veprimtaria e Rexhep Qosjes, si njëri nga studiuesit që kishte botuar disa shkrime në “Rilindje”. “Konferenca që do të organizohej në fillim të këtij viti, për 100-vjetorin e F. S. Nolit, nga Instituti Albanologjik i Prishtinës, duhet të jetë anuluar. "Rilindja" u kufizua me botimin e disa artikujve për krijimtarinë e F.Nolit, shumica e të cilëve trajtonin çështje anësore dhe nuk preknin problemet që kishin të bënin me veprimtarinë e krijimtarinë patriotike të F.Nolit. Vetëm në një studim të Rexhep Qosjes, që u botua në "Rilindja", në mars të këtij viti, me titullin "Fan Noli dhe modeli kritik i kulturës shqiptare", bëhet një vlerësim më i plotë i F.Nolit, i përmbajtjes politike-shoqërore dhe i frymës patriotike, antizogiste e demokratike të poezisë e krijimtarisë së tij në tërësi. R. Qosja vlerëson në mënyrë të veçantë kontributin e F.Nolit në "glorifikimin e bashkëpunëtorëve të vet, të shokëve të luftës dhe të ideologjisë, Luigj Gurakuqit e Bajram Currit, të cilët ka vënë në pedestalin e luftëtarëve për lirinë, demokracinë dhe pavarësinë e popullit shqiptar”⁵⁸-shkruan në mes tjerash në këtë studim.

Në vitin 1989, prej datës 15 deri më 28 gusht, mbahet në Prishtinë, Seminari i XV Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare. Në këtë Seminar, me kumtesa nga Tirana kishin marr pjesë studiuesit: Androkli Kostallari, Mahir Domi dhe Dalan Shapllo, të cilt në muajin shtator kishin dërguar një informacion rreth qëndrimit të tyre në Kosovë. Profesor Rexhep Qosja përmendet si njëri nga përfaqësuesit e elitës intelektuale nga Kosova, me të cilët ishin takuar ata. Përgatitësit e informacionit, gjatë qëndrimit të tyre në Prishtinë, veqojnë një kërkesë të Profesor Qosjes, drejtuar atyre. “Shokët kryesorë kosovarë e në mënyrë të veçantë Rexhep Qosja”⁵⁹-shkruajn ata, “shtruan disa herë çështjen e trajtimit të letërsisë kosovare në shkollat e Shqipërisë dhe në tekstet përkatëse, duke përfshirë edhe tekstet e shkollave të larta e veprat përgjithësuese të Akademisë së Shkencave. Nuk e kuptojmë, thanë ata, një qëndrim të tillë, kur në tekstet e shkollave të larta ka gjetur vend trajtimi i letërsisë së sotme arbëreshe, por nuk ka gjetur vend letërsia kosovare. Ata mendojnë se ka ardhur koha që në Shqipëri nga

⁵⁵ *Rilindja*, 16 dhjetor, Prishtinë, 1980, f. 8.

⁵⁶ *Rilindja*, 18 dhjetor, Prishtinë, 1980, f. 10.

⁵⁷ *AQSH*, F. 14APSTR, V. 1980, D. 86, fl. 43. Informacion mbi disa probleme të veçanta që dolën gjatë qëndrimit në Kosovë të grupit të gjuhëtarëve të Akademisë së Shkencave, që mirën pjesë në Simpoziumin shkencor kushtuar probleme aktuale të kulturës së gjuhës shqipe. Tiranë, më 22 dhjetor 1980.

⁵⁸ *AQSH*, F. 14APPK KOSOVA, V. 1982, D. 50, fl. 14. Studim: “Gjendja e studimeve albanologjike në Kosovë pas ngjarjeve të mars-prillit 1981”. Tiranë, më 3 maj 1982.

⁵⁹ *AQSH*, F. 14APSTR, V. 1989, D. 1637, fl. 15. Informacion mbi pjesëmarrjen e studiuesve tanë në Seminarin XV Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare në Prishtinë. Tiranë, më 20 shtator 1989.

institucionet përkatëse të shqyrtohet seriozisht kjo çështje, sidomos tani që në Kosovë janë botuar shumë vepra letrare dhe studime për to, disa prej të cilave janë ribotuar edhe në Shqipëri. Trajtimi i letërsisë së sotme kosovare në tekstet e në shkollat e Shqipërisë, theksuan ata, do t'ia ngrinte prestigjin letërsisë kosovare në Jugosllavi, sepse serbet përpiqen ta paraqesin atë si letërsi provinciale, pa ndonjë vlerë”⁶⁰-shkruan në mes tjerash në këtë informacion.

Gjithashtu, në të njëjtin informacion, ata shënojnë edhe për një informacion të cilin e kish marr nga Profesor Rexhep Qosja në lidhje me takimin e tij me disa parlamentar evropian se bashku me Ibrahim Rugoven. “Rexhep Qosja na tregoi se ai, bashkë me Ibrahim Rugovën, ia treguan komisionit parlamentar evropian gjendjen e Kosovës, fare lakuriq, me fakte të shumta, të cilat krijuan bindje të qarta te ky komision; për këtë Rexhep Qosja mori me vete një përkthyes që e zotëron shumë mirë gjuhën frenge dhe nuk pranoi të fliste pa këtë përkthyes”⁶¹- shkruanin në mes tjerash në këtë informacion.

Përfundim

Nuk pretendojmë, se kemi tubuar të gjithë materialin arkivor të Shtetit Shqiptar, në lidhje personalitetin e Profesor Rexhep Qosjes. Por, për aq sa kemi arritur të hulumtojmë dhe të vjelim materiale arkivore, mund të thuhet, se puna shkencore e profesor Rexhep Qosjes, në përgjithësi vlerësohej me nota pozitive. Ai shikohej si një talent në fushën e kritikës letrare dhe prodhimtar në këtë drejtim. Njëri që e çmonte punën shkencore të Institucioneve Tiranës në fushën e albanologjisë. Kumtesat e mbajtura nga ai, sipas tyre, shquhen për mendimet e thella dhe trajtimet metodologjike. Edhe atëherë, kur e theksojnë për disa qëndrime, mospajtuere të Profesorit në lidhje me kritikën dhe historinë e letërsisë shqiptare në Tiranë, ata janë të kujdesshëm në mënyrën e formulimit se si e shprehin në relacione. Por, dokumentacioni që kemi në dispozicionin tonë, tregon se studiuesit e Tiranës, ishin të shqetësuar me mendimet e Profesor Qosjes, rreth periodizimit të letërsisë shqiptare.

Mbrojta e disertacionit, të Profesor Qosjes nga dy anëtarët e komisionit nga Tirana, vlerësohet mjaft mirë dhe si akt patriotik.

Në çdo relacion, informacion etj., po thuajse e potencojnë mirënjohjen e Profesor Qosjes ndaj institucioneve shkencore të Tiranës dhënë studiuesve shqiptare në Jugosllavi dhe institucioneve të tyre shkencore.

Gjuha me tone të ashpra, e studiuesve të Tiranës, ndaj Rexhep Qosjes dhe veprës së tij, del në shesh me rastin, e botimit të veprës “Morfologjia e një fushate”. Siç duket, shpërputhja e qëndrimeve të Rexhep Qosjes, me studiuesit e Tiranës, ndaj disa aspekteve të studimeve letrare, të shprehura më herët, do të gufoj, me tonë të ashpra nga studiuesit e Tiranës, ndaj Rexhep Qosjes, me rastin e botimit të kësaj vepre.

Por, mendimet e kolegëve të Prishtinës, për Profesor Qosjen, të cilat shënohen nga përgatitësit e relacioneve në Tiranë, duken se janë me nuanca subjektive edhe doza inati.

Profesor Rexhep Qosja, në të gjitha ato materiale që kemi hulumtuar deri me tani, duket mjaftë i matur në deklaratimet e tij për çështje profesionale, dhe i kujdesshëm kur fletë për individ të caktuar.

⁶⁰ Po aty.

⁶¹ Po aty, fl. 17-18.